



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 30, Datë 21.02.2020

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “KASTRATI ENERGY” SH.P.K. PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ANA E ERE-S PËR SHITJEN E 80 % TË KUOTAVE TË KAPITALIT**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pikës 5.2 të “Licencës së Veprimtarisë së Tregtimit të Energjisë Elektrike”; pikës 9.2 të “Licencës së Veprimtarisë së Furnizimit të Energjisë Elektrike”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.02.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “KASTRATI ENERGY” sh.p.k., si dhe relacionin nr.28/6 Prot, datë 06.02.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, Mbi kërkesën e shoqërisë KASTRATI ENERGY sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ana e ERE-s për shitjen e 80% të kuotave të kapitalit të shoqërisë KASTRATI ENERGY sh.p.k.

Konstatohet se:

- Shoqëria “Kastrati Energy” sh.p.k., regjistruar në QKB me NUIS L91325503D, është mbajtëse e licencës nr. 438, seria T19, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 38, datë 07.03.2019, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, si dhe e licencës nr. 439, Seria F19, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 39, datë 07.03.2019, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.
- Në zbatim të pikës 3.6.4 të Licencës për Veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, dhe pikës 4.4 të Licencës për Veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike, i Licensuari ka njoftuar ERE-n brenda 10 ditëve, për ndryshimet si më poshtë:
 - Është ndryshuar administratori i shoqërisë
 - Është ndryshuar emri i shoqërisë nga “KASTRATI ENERGY” sh.p.k., në “EZ-5 ENERGY” sh.p.k..
- Gjithashtu, me anë të kësaj shkrese, shoqëria “KASTRATI ENERGY” sh.p.k., ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ana e ERE-s për shitjen e 80 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë, e përbërë nga 1 kuotë, që zotërohen nga ortakët “Kastrati Construction” sh.p.k.
- Në mbështetje të kërkesës për autorizimin nga ana e ERE-s, shoqëria ka depozituar:
 - Vendimin e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë datë 21.01.2020 i cili parashikon hyrjen në fuqi pas miratimit nga ERE

- Kontratë shitje kuotash dhe kapitalesh, nr. 230 Rep., nr. 124 Kol., datë 21.01.2020.
- Ekstraktin historik të regjistrit tregtar për të dhënat e shoqërisë.
- Vërtetimin nr. T01765847, datë 28.01.2020, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- Vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Vërtetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës se Administratori i shoqërisë nuk ndodhet në proces penal.
- Kërkesa e Shoqërisë Kastrati Energy sh.p.k, është mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe nga shqyrtimi i saj si dhe dokumnetacionit të depozituar nga shoqëria në ERE, rezulton se ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore si i licencuar në aktivitetet e tregëtimit dhe furnizimit.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Autorizimin e Shoqërisë “KASTRATI ENERGY” sh.p.k për shitjen e 80% të kuotave të kapitalit të shoqërisë të zotëruara nga shoqëria “Kastrati Construction” sh.p.k. sipas kërkesës.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI